



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 246, datë 21.12.2020

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME KËRKESËN E SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” SH.P.K, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.

Nisur nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 135/15 prot, datë 17.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1156 Prot, datë 02.11.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Pishat, me vendodhje në përroin e Holtës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
- Po ashtu, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 184, date 13.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Pishat” me kapacitet të instaluar 1991 kW, për një afat 30 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën me nr. 62/37 prot., datë 16.11.2020 për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 1155/1 prot, datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar nga aplikimi i saj.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19.

- Në nenin 14, pika 2, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*, përcaktohet se për centralet e lidhur drejtëpërdrejtë me rrjetin e shpërndarjes, dhe për të gjitha licencat e tjera Bordi merr vendim jo më vonë se 30 ditë pune nga data e publikimit të parë të njoftimit në shtyp për aplikimin në shtyp, ndaj për kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” shpk Bordi duhet të marrë vendimin përfundimtar brenda datës 31.12.2020.
- Në nenin 53, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë përcaktohet se:
 - 3. *Afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit.*
- Kërkesa e shoqërisë për zgjatje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është bërë përpara mbarimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë me 30 ditë punë afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI